

Informata për marrjen në pyetje në procedurën penale

Në qoftë se bëni kallxim (denoncim) pranë policisë, Raporti i policisë (protokolli i juaj i marrjes në pyetje) shkon te prokuroria. Atje edhe njëherë do të merreni në pyetje, sipas nevojës edhe njëherë tjetër pranë gjykatës. Këto informata do të duhej t'ju ndihmojnë për t'u parapërgaditur:

Informata të përgjithëshme

- Në qoftë se e keni pranuar terminin për marrje në pyetje, ju jeni i/e detyruar të shkoni. Në qoftë se ju duhet ta shtyni terminin, atëherë jeni i/e detyruar të lajmëroheni në Tel. 055 646 69 20.
- Në qoftë se ju gjatë marrjes në pyetje dëshironi të shoqëroheni nga një person i besueshëm, jeni e/i detyruar ta njoftoni prokurorinë para terminit të marrjes në pyetje (letërnjoftimet i merrni me vete). Është e dëshirueshme, që pas marrjes së ftesës, sa më shpejt që të jetë e mundur, më së voni dy deri tre ditë para marrjes në pyetje, ta paralajmëroni shoqërimin e besueshëm dhe ta jepni emrin e personit që ju shoqëron.
- Në qoftë se dëshironi që i pandehuri t'mos qëndrojë në të njëjten dhomë gjatë kohës sa ju merreni në pyetje, ju mundeni gjithashtu ta njoftoni prokurorinë para terminit, atëherë do të kërkohet një zgjidhje tjetër.

Rrjedha

- Paraqituni në kohë te zyra e pritjes së prokurorisë dhe tregoni letërnjoftimin tuaj.
- Në fillim të marrjes në pyetje do të prezentohen të gjithë të pranishmit.
- Në fillim do të njoftoheni për detyrimet dhe të drejtat tuaja.
- Merrni kohë. Përgjigjuni saktë në të gjitha pyetjet.
- Tregoni hapur, në qoftë se nuk e kuptoni ndonjë pyetje. Tregoni hapur, në qoftë se përgjigjen duhet ta mendoni mirë ose në qoftë se nuk e dini përgjigjen. Merrni guxim për të raportuar hollësisht.
- Në rast të dhunës në partneritet do të shtrohen pyetje të pakëndëshme. Në qoftë se pyetjet kanë të bëjnë me gjendjen faktike, përpiquni të jepni përgjigje. Në qoftë se pyetjet nuk kanë të bëjnë me gjendjen faktike, nuk jeni i/e detyruar të përgjigjeni, për shembull: «A e keni tradhëtuar ndonjëherë burrin tuaj?»

- Prokuroria mundet t'i ripërsëris pyetjet për ta konstatuar më mirë rrjedhen aktit të dhunës. Ajo nuk e bën këtë për të ushtruar presion ndaj jush.
- Në çdo kohë mund të kërkonti pauzë.
- Mbas marrjes në pyetje avokati i juaj apo avokati i të pandehurit mundet të parashtroj pyetje.
- Në fund jeni i/e detyruar ta lexoni protokollin e marrjes në pyetje dhe ta nënshkruani çdo faqe. Në qoftë se diçka është shkruar ashtu siq ju nuk keni thënë, njoftojeni këtë menjëherë. Pastaj ju me dorëshkrim tuj mund ta bëni korrigjimin në protokoll.

Këshilla

- Vishuni ashtu që të ndiheni rehat, megjithatë me kujdesë dhe sipas situatës.
- Merrëni me vete diçka për të pirë (PET-shishe) dhe në rast nevojë glukozë, një top dore për masazh (për ta ngjesh).
- Planifikoni një pauzë pushimi mbas marrjes në pyetje, në të cilën mund të qëndroni vetëm apo sëbashku me shoqëruesin apo shoqëruesen. Mbas marrjes në pyetje ju mund të takoheni edhe me personin këshillëdhënës të Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave (ju lutemi ta caktoni këtë termin më parë).

Asnjë marrje në pyetje nuk është si tjetra. Nuk do të procedohet strikt sipas katalogut të pyetjeve. Për këtë arsye rrjedha mund të jetë pak më ndryshe ngaqë është përshkruar në këtë fletë. Në qoftë se nuk ndiheni e sigurtë, ne ju këshillojmë me dëshirë. Ju dëshirojmë shumë sukses!